



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.896/20

912/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Blerim Dina – Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenkovic – Antarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “Rojet e Nderit” SH.P.K-Prishtinë dhe OE “K.S.Besa Security” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Internat Security Association SH.P.K & Nazeri 2000” SH.P.K, Dega në Kosovë-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me nr. të prok: 616-19-3238-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”, më datën: 02.12.2020, mori këtë:

### V E N D I M

**I. APROVOHEN**, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “Rojet e Nderit” SH.P.K-Prishtinë dhe OE “K.S.Besa Security” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me nr. të prok: 616-19-3238-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me nr. të prok: 616-19-3238-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”, dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “Rojet e Nderit” SH.P.K-Prishtinë dhe OE “K.S.Besa Security” SH.P.K-Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i'u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues “Rojet e Nderit” SH.P.K-Prishtinë dhe OE “K.S.Besa Security” SH.P.K - Prishtinë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 06.11.2020 me nr. 896/20 dhe me 09.11.2020 me nr. 912/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me nr. të prok: 616-19-3238-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 10, 59, 60, 65 dhe 72 të LPP-së, te ankesa me nr. 896/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 56.3, 57, 59, 61 dhe 72 të LPP-së, te ankesa me nr. 912/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 11.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 19.11.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Rojet e Nderit SH.P.K” – PRISHTINË - Ankesa 896/20**

Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes së tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

**Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 1**



Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 10, 59, 60, 65 dhe 72 të LPP-së dhe vendimet e OSHP-së, me arsyetimin se: “OE ankuese ka parashtruar ankesë përveç që në disa faqe të ankesës ka paraqitur-përshkruar kronologjinë rreth veprimeve të marra nga AK dhe OSHP lidhur me këtë aktivitet” duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lendes ekspertit shqyrtues konstaton se OE ankuese vetëm ka bërë përshkrim kronologjik të rrjedhës së aktivitetit duke potencuar disa nga kërkesat dhe sqarimet e bëra nga AK në fazën para dorëzimit të ofertave e të cilat kërkesa kanë qenë pretendime dhe janë trajtuar me vendimet e OSHP-së nr. 735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, Vendimi e OSHP-së, PSH 82-83-92/20 dt. 03.03. 2020, Vendimi e OSHP-së, PSH 332/20 dt. 25.05.2020 si dhe Urdhëresën e OSHP-së, PSH 563/20 dt. 14.10. 2020.

**Lidhur me pretendimin e OE ankuese**“ lidhur me vendimin e fundit të marur nga Menaxheri i Prokurimit i AK-së duke u thirrur në urdhëresën e OSHP-së” duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lendes ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankuese është pjesërisht i bazuar sepse bazuar në nenin 59 të LPP-së AK respektivisht ZKA dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit duhet të krijoj komision vlerësimi për vlerësim të tenderëve respektivisht në paragrafin 40.1 dhe 40.2 të RRUOPP, ku theksohet :”40.1 Duke ju referuar nenit 59, paragrafi 1, i LPP-së, për të gjitha aktivitetet e prokurimit AK, respektivisht “ZKA” në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit duhet të krijoj një komision të vlerësimit të tenderëve me funksione krejtësisht këshilluese për Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit. Nga ky rregull përjashtohen aktivitetet e prokurimit me vlere minimale. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të bëjë rekomandimin për anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve për ZKA, i cili do të aprovoj të gjitha nominimet ose kur është e nevojshme do të zgjedh anëtarë alternativ për Komisionin. Anëtarët e komisionit të hapjes së tenderëve mund të shërbejnë si anëtar të komisionit të vlerësimit. 40.2 Komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast. Komisioni i vlerësimit do të vlerësoj tenderët në pajtim me kriteret e specifikuar me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si më i mirë.” Në rastin konkret zyrtari përgjegjës i prokurimit i AK ka marr vendim duke u bazuar në paragrafin 40.13 të RRUOPP, ku theksohet : ”40.13 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Në situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim.” Mirëpo i njëjti zyrtar respektivisht AK me rastin e publikimit të formularit “B58 Formularit mbi vendimin e autoritetit kontraktues” në platformën e E-prokurimit nuk i ka bashkangjitur letrat standarde siç parashihet me paragrafit 43.2 të RRUOPP, ku theksohet: “43.2 Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe Letrat Standarde përkatëse për Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme”, por me

rastin e publikimit të formularit B58 të njëjtit i është bashkangjitur vetëm Vendimi i marrur nga zyrtari përgjegjës i prokurimit i datës 19.10.2020.

**Lidhur me pretendimin e OE ankuese** “se në dokumentacionin e grupit të OE të rekomanduar për kontratë respektivisht në ofertën financiare dëshmitë lidhur me vërtetimin e ATK-së të Internacional Security Association SH.P.K” duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet lidhur me ofertën financiare respektivisht çmimeve në ofertë, të njëjtat pretendime janë trajtuar me vendimet e OSHP-së nr. 735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, Vendimi e OSHP-së, PSH 82-83-92/20 dt. 03.03. 2020, Vendimi e OSHP-së, PSH 332/20 dt. 25.05.2020 si dhe Urdhëresën e OSHP-së, PSH 563/20 dt. 14.10. 2020.

**Ndërsa, lidhur me pretendimin e OE ankuese**, rreth vërtetimin të ATK-së të anëtarit të konzorciumit “Internacional Security Association SH.P.K” duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lendes eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk është i bazuar sepse ky aktivitet i prokurimit është shpallur/publikuar nga AK në platformën e E-prokurimit me datën 20.05.2019 ndërsa anëtari i konzorciumit të rekomanduar për kontratë “Internacional Security Association SH.P.K” ka dorëzuar Vërtetimin e ATK-së, të nxjerrur me datën 11.04.2020, në të cilin është theksuar se “është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura” andaj vërtetimi si i tillë, plotëson kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

**Lidhur me pretendimin e OE ankuese** si dhe pretendimet se “Nazeri 2000 SH.P.K” ka masë administrative të lëshuar nga institucionet e Shqipërisë si dhe për drejtuesin tjetër të kësaj kompanie Mehmet Bazaj me arsyetim se i njëjti është dënuar nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Durrës për vepër penale Shpërdorim Detyre dhe nga këto dokumente konstatohet se ky OE nuk i përmbush kriteret e përcaktuara nga AK në dokumentacionin e tenderit.” duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e larte cekura operatori ekonomik ankues nuk i ka parashtruar me kërkesën për rishqyrtim në AK, andaj pretendimet në fjale nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues në përputhje me paragrafin 1 të nenit 109 të LPP-se dhe nenin 9 të “Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave”. Përkundër kësaj duke pas parasysh faktet e ofruara me ankesën e dorëzuar nga OE ankuese ndaj dokumentacionit/dëshmimeve të anëtarit të konzorciumit të rekomanduar për kontratë OE “Nazeri 2000 SH.P.K”, eksperti shqyrtues mendon se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave duhet të marrë parasysh pretendimet e OE ankuese dhe të verifikojë dëshmitë e të anëtarit të konzorciumit të rekomanduar për kontratë OE “Nazeri 2000 SH.P.K”.



PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “K.S.Besa Security SH.P.K.”-PRISHTINË -Ankesa 912/20.

Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

#### **Përgjigje në Pretendimin ankimor nr. 1**

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 56.3, 57, 59, 61 dhe 72 të LPP-së, me rastin e refuzimit të tenderin tone me arsyetimin: “OE ankuese ka parashtruar ankesë, ka paraqitur pretendim lidhur me vendimin e fundit të marrur nga Menaxheri i Prokurimit i AK-së duke u thirrur në urdhëresën e OSHP-së pa bërë vlerësim dhe krahasim të ofertave”

duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankuese është pjesërisht i bazuar sepse bazuar në nenin 59 të LPP-së AK respektivisht ZKA dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit duhet të krijoj komision vlerësimi për vlerësim të tenderëve respektivisht në paragrafin 40.1 dhe 40.2 të RRUOPP, ku theksohet :”40.1 Duke ju referuar nenit 59, paragrafi 1, i LPP-së, për të gjitha aktivitetet e prokurimit AK, respektivisht “ZKA” në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit duhet të krijoj një komision të vlerësimit të tenderëve me funksione krejtësisht këshilluese për Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit. Nga ky rregull përjashtohen aktivitetet e prokurimit me vlerë minimale. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të bëjë rekomandimin për anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve për ZKA, i cili do të aprovoj të gjitha nominimet ose kur është e nevojshme do të zgjedh anëtarë alternativ për Komisionin. Anëtarët e komisionit të hapjes së tenderëve mund të shërbejnë si anëtar të komisionit të vlerësimit. 40.2 Komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast. Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë tenderët në pajtim me kriteret e specifikuar me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si më i mirë.” Në rastin konkret zyrtari përgjegjës i prokurimit i AK ka marr vendim duke u bazuar në paragrafin 40.13 të RRUOPP, ku theksohet : ”40.13 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Në situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim.” Mirëpo i njëjti zyrtar respektivisht AK me rastin e publikimit të formularit “B58 Formularit mbi vendimin e autoritetit kontraktues” në platformën e E-prokurimit nuk i ka bashkangjitur letrat standarde siç parashihet me paragrafit 43.2 të RRUOPP, ku theksohet: “43.2 Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe Letrat Standarde përkatëse për Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme”, por me rastin e publikimit të formularit B58 të njëjtit i është bashkangjitur vetëm Vendimi i marrur nga zyrtari përgjegjës i prokurimit i datës 19.10.2020.

**Lidhur me pretendimet e OE ankuese** “ndaj dokumentacionit te grupit te OE te rekomanduar për kontratë respektivisht në ofertën financiare respektivisht mos plotësimit të kushtit prej 250 € *pagë* për punëtor dhe pretendimin rreth çmimeve jo normalisht të ulëta” duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet lidhur me ofertën financiare respektivisht çmimeve në ofertë, të njëjtat pretendime janë trajtuar me Vendimin e OSHP-së nr. 735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, Vendimin e OSHP-së, PSH 82-83-92/20 dt. 03.03.2020, Vendimin e OSHP-së, PSH 332/20 dt. 25.05.2020 si dhe Urdhëresën e OSHP-së, PSH 563/20 dt. 14.10.2020.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen si pjesërisht te bazuara, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës si dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 19.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 23.11.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar, konfirmojmë pranimin e ekspertizës dhe deklarojmë se nuk pajtohemi me përgjigjet dhe mendimin e ekspertit shqyrtues. Vetëm duam t'ua përkujtojmë me këtë rast se Autoriteti Kontraktues, respektivisht unë si zyrtar përgjegjës kam vepruar ne harmoni me Urdhëresën e OSHP-se, e cila decidivisht ka kërkuar që AK-ja ti respektoj ne tërësi vendimet paraprake dhe sa i përket vërejtjes për mos krijim te komisioneve te vlerësimit kjo nuk qëndron pasi që ne baze te tyre me pare janë formuar komisionet që kane dhënë rekomandimet e tyre, por sipas Urdhëresës ka rezultuar se nuk janë respektuar Vendimet paraprake. Po ashtu ne ato rekomandime është propozuar pikërisht tenderuesi që ka parashtruar ankese dhe sikur te ishte rekomandim i drejte atëherë nuk do te vinte Urdhëresa e OSHP-se. Dhe bazuar ne këtë duke respektuar Urdhëresën është rekomanduar i vetmi tenderues që sipas Vendimeve paraprake është konsideruar si i përgjegjshëm. Me respekt,

Operatori Ekonomik: “Rojet e Nderit” SH.P.K-Prishtinë, me datë 20.11.2020, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

**PËRGJIGJEJE NË EKSPERTIZË**, Të nderuar, Duke shprehur respektin dhe konsideratën për ju kërkojmë: **VËMENDJE!!!** Para se të japim mendimin tonë lidhur me pajtimin ose jo me mendimin e ekspertit ne do të para shtrojmë disa pyetje pse në secilën ekspertizë dhe vendim është kaluar kjo çështje ose thënë më sakët nuk është gjykuar drejtë. Kërkesat e AK-së Në DT: a) Kërkesa 2. OE DUHET TE DEKLAROHET SE



PUNETOREVE DO TUA PAGUAI PAGEN MINIMALE BRUTO 250€ Sqarimi në ANEKS 1 ku keni cekur qartë se: Paga bruto mujore për një punëtor nga Ofruesi i shërbimeve kërkohet të jetë së paku 250 € për një muaj. Në rast se gjatë implementimit të kontratës, Qeveria e Kosovës nxjerr një vendim për pagat minimale të punëtorëve të sektorit privat, OE merr përsipër që të rris pagën mujore në përputhje me vendimin. Në këtë rast nuk do të ketë ndryshim të çmimit të ofertuar mirëpo OE do të jete i obliguar që të zbatojë vendimin e Qeverisë. Nga operatori ekonomik kërkohet që të dorëzojë një deklaratë origjinale të vulosur dhe të nënshkruar se do të respektojë pagën bruto mujore për një punëtor. Po ashtu kërkohet të respektohet Ligji i punës dhe rregullat e aplikueshme lidhur me orët e punës për një muaj. **SQARIMII AK-së.** 1. Lidhur me pyetjen tuaj referohuni dosjes së tenderit, saktësisht Aneksit 1 tek specifikimet teknike që do të thotë se Tenderuesit që nuk përfshijnë në çmim të gjitha kostot sipas Ligjit të Punës do të eliminohen. Ligji i punës parash këto të drejta për punëtor: Siç jemi dijeni Ligji i Punës parashëh këto të drejta: Neni 56 Paga shtesë 1. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuarit ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës. 2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë: 2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës; 2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit; 2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 2.5. 50 % në orë për punë gjatë fundjavës. Si dhe Neni 32 Pushimi vjetor 1. I punësuarit gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar. 2. Zgjatja e pushimit vjetor përcaktohet varësisht nga stazhi i punës, ku për çdo pesë (5) vite të përvojës së punës, shtohet një ditë pune. 3.1 punësuarit i cili punon në punët dhe detyrat e punës për të cilat përkundër aplikimit të masave mbrojtëse nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme, ka të drejtë në pushim vjetor në kohëzgjatje së paku prej tridhjetë (30) ditësh pune, për vitin kalendarik. 4. Nënata me fëmijë deri në tri (3) vjeç si dhe prindi vetushqyes dhe personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në pushim vjetor edhe për dy (2) ditë pune shtesë. 5. Ditët e pushimit nuk mund të kompensohen me para, përjashtimisht kjo mund të bëhet kur marrëdhënia e punës i skadon të punësuarit. 6. Punët dhe detyrat e punës sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga MPMS-ja. 1. Nëse ligji i punës parash këto të drejta dhe AIK ka kërkuar të zbatohen pse në analizën financiare të OE të rekomanduar nuk janë përfshi pse nuk po elaborohet ky fakt? Ku OE në analizë financiar ka paraqitur: i. Në duke u bazuar në ligjin e punës, dhe pagës së kërkuar nga AK përmes dosjes së tenderit, kërkesa e kalkuluar dhe zbërthyer orët punuese sikurse në vazhdim: Llogaritja e pagës Paga sipas kërkesave në DT është 250 Euro, Duke u bazuar se orët e rregullta të punës mesatare për një muaj janë 176 orë dhe duke u bazuar listën e përshkrimit të çmimeve në DT shohim se 22.22% e orëve janë ndërrimi i natës kurse 77.78% janë ndërrimi i ditës, dhe Duke u bazuar në ligjin e përpjesëtueshmërisë matematikore gjejmë çmimin e orës për pagesë për punëtor e që është 1.333 EURO /Orë.  $250\text{EURO}/\text{MUAI} = 0.78 \times 1.333 \times 176 + 0.22 \times 1.333 \times 176 \times 1.3 \dots$  Relacion 1 ku është 0.78 (77.78%) koeficienti i përqindjes për orët

e ditës 0.22 (22.22%) koeficienti i përqindjes për orët e natës 1.333 Çmimi i pagesës për një orë 1.3 (30%) koeficienti i orëve të punës në ndërrimin e natës Sipas ligjit të punës Nr. 03/L-212. Kjo analizë përveç se është shumë e mangët është edhe shumë ofenduese për të drejtat e punëtorëve Ligjin e Punës vetëm një INJORANT nuk mund ta kuptoj se kjo analizë është thjeshtë Kamuflim dhe asgjë më shumë përmend Ligjin e Punës nuk parasheh, PUSHIM VJETOR. VIKENDE, FESTA etj (vetëm nëse ka zbuluar një ligj paralelë), të nderuar nuk është e pranueshme një analizë e tillë sepse përmban elemente shumë të ultë dhe tendencioze

për shkelje të drejtave të punëtorëve. Pse këtë fakt nuk e ka shqyrtuar eksperti. Fakti tjetër: Sa i përket numrit të punëtorëve ne do e qartësojmë shumë thjeshtë sqarim të çiles edhe ju edhe OE-të tjerë kanë kalkuluar në këtë formë:

Pjesanr.	Përshkrimi i pozitës (a)	Numri i pozitave (b)	Numri i orëve (c)	Numri total i orëve për ditë (d) = (b) x (c)	Numri total i orëve për 30 ditë (e) = (d) x 30	Nr 1 orëvemuore / 176 sipasligjit tëpunës
1	Sigurimifizik	35	24 orë	840 orë	25200	25200/176= 143.18
2	Sigurimifizik	1	16 orë	16 orë	480	480/176 = 2.73
3	Sigurimifizik	18	12 orë	216 orë	6480	6480/176= 36.82
4	Sigurimifizik	28	8 orë (nga 08:00-16:00)	224 orë	6720	6720/176= 38.18
Nr 1 punëtorve						220.91



Pra me një formë shumë të thjeshtë dhe të kapshme nr i punëtorëve nxjerrët atë në një saktësi të madhe pasi që kërkesat tuaja kanë qenë të qarta dhe të lehta për tu kuptuar. Një kalkulim i thjeshtë pa llogaritur Ligjin e Punës por vetëm bazat e pagës dhe TVSH.

Nr	Paga Bruto	Trusti Pensional	Paga + trusti	Nr Punëtorëve	Total Paga pa TVSH	Total Paga me TVSH
1	€250.00	€12.50	€262.50	220.91	€57,988.88	€68,426.87
2					Totali për një muaj	€68,426.87
3					Totali për 36 muaj	€2,463,367.41

2. Nëse vlerësimi, rivlerësimi duhet të bëhet sipas kërkesave të DT, sqarimeve të dërguara pse nuk merren për bazë këto fakte. Të nderuar pa dashur të lëshohemi duke ju lutur dhe duke kaluar nga ajo e profesionale dhe etikes duke kërkuar të zgjojmë moralin e secilit për drejtësi dhe prekje të ndërgjegjes kërkojmë të merrni për bazë pretendimet e mirë detajuar lidhur me kërkesat e AI< lidhur me të drejtat e punëtorëve. Ku AK rekomandon një OE pa asnjë kriter të plotësuar. Sa i përket mos përfshirjes së provave në kërkesë për ri-shqyrtim ne japim arsyetimin se ky grup i OE nuk ka qenë asnjëherë pjesë e garës pasi që ka qenë i eliminuar dhe se nuk kemi pas interes të merremi me të. Por se pas shumë ankesave AK pa vlerësim, kriter dhe ndonjë bazë e ka rekomanduar dhe në mungesë të kohës dhe për arsye se kemi qenë duke grumbulluar prova nuk kemi mundur t'i paraqesim në kërkesë për ri-shqyrtim provat janë reale dhe zyrtare nga institucionet dhe bazuar në LPP ky grup i OE nuk është i përshtatshëm.

Kërkojmë që të merren për bazë këto prova nga Paneli shqyrtues duke aprovuar ankesën tonë në të gjitha pretendimet pasi që janë mirë të formuluar mbështetura në ligjet në fuqi si dhe kërkesat e AK. Ndaj deklarojmë se Pjesërisht pajtohemi me mendimin e ekspertit duke kërkuar qartësim të pyetjeve të lartë shënuara! P.S Duke ju kujtuar se shpresojmë në drejtësinë tuaj!

Operatori Ekonomik: "K.S. Besa Security "SH.P.K-Prishtinë, me datë 23.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Për:Organin Shqyrtues të Prokurimit, Panelin Shqyrtues. Nga OE: K.S. "Besa Security" SH.P.K.

Lënda: Plotësimi ankesës për tenderin me titull: "Sigurimi i Objekteve të Komunës së Prishtinës", me numër të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1 Dt. 13.11.2020 Të nderuar, Në ankesën tone kemi parashtruar pretendimet tona lidhur me kundërshtimin për OE e rekomanduar për kontratë dhe eliminimin tone nga ky aktivitet i prokurimit. OE I rekomanduar për kontratë ka ofertën në kundërshtim me nenin 61 të LPP sepse çmimet e

saja janë jo normalisht të ulët dhe nuk plotësojnë kërkesën në DT dhe NJPK që AK ka kërkuar. Ju njoftoj edhe një herë si më poshtë:

OE ISA & NAZERI janë të pa përgjegjshëm pasi që me çmimin 1,70Eur për ore pune (dëshmia e bashkangjitur), nuk kanë respektuar as kalkulimin sipas kalkulatorit të ATK-se (<http://ëëë.atk-ks.org/33184-2/>) 250Eur bruto + kontributi i pune dhënësit 5% = 262.5Eur për punëtorë pjesëtuar me 176h në muaj sipas udhëzimit administrativ të Qeverisë të datës 28 Dhjetor 2017. Me rast,  $262,5 / 176 = 1,49\text{Eur/h}$ . Pastaj,  $1,49\text{Eur/h} + 18\% \text{ TVSH} = 1,76\text{Eur/h}$ . Kjo e ve në pah që çmimi i ISA & Nazeri me 1.70Eur/h me TVSh, nuk e mbulon as pagën bruto + kontributin pensional në vlerë 1,76Eur me TVSh. Ndërsa, Besa Security siç ka deklaruar, paga 250Eur bruto është paga e një punëtori për 12 muaj, që nënkupton që përfshinë pushimin vjetor, ndërsa zëvendësimin e tij gjatë pushimit vjetor do ta bëjnë punëtorët që i kemi rezerve dhe që i paguajmë konform udhëzimit administrativ të Qeverisë 130Eur. Vikende në sigurim nuk ka, për këtë kemi interpretimin e inspektoratit të punës, shikoni emalin më poshtë. Gjithashtu, për çdo eventualitet kemi lenë 1 eur për 1 punëtorë, për shpenzime shtese apo fitim eventual të kompanisë. Andaj, oferta jone është 100% e përgjegjshme sipas njoftimit me sipër dhe sipas kalkulimit (të bashkangjitur) në Excel.

Nga kjo që u sqarua më lartë gjejmë se OE I rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kriterin e kërkuar që paga të jetë bruto 250 euro dhe nga kalkulimi I më sipërm është e evidente se I njëjti është I pa përgjegjshëm. AK me rastin e ri-vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 për tenderët jo normalisht të ulët si dhe në kundërshtim me Rregullat për tenderët jo- normalisht ulët përkatësisht në kundërshtim me nenin 3 dhe 4 të po këtyre rregullave, nga DT dhe në raportin e vlerësimit dhe ri-vlerësimit nuk kemi gjetur se AK ka ndërmarr veprim që siguron se OE I rekomanduar ka sqaruar se si ka ardhë deri te formulimi i këtij çmimi i cili është në kundërshtim me kërkesën e AK. Shih si më poshtë këto dispozita të këtyre rregullave: Neni 3 Informatat e përgjithshme Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së. Neni 4 Procedura e shqyrtimit (inter partes) Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 3.1 ose 3.2 të këtyre rregullave, një tender i tillë nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktojnë tenderin veçanërisht të ulët. Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbatim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila



përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët". Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet. Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara. Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 4.4 të këtyre rregullave, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose: Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit abnormalisht të ulët", brenda dy dite nga data e vendimit. Tenderuesi në fjalë do të informohet për rezultatin final të vlerësimit. Po ashtu edhe neni 61.1. e sqaron këtë situatë citat/Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni." Nga sa u tha më lartë edhe sikur AK të kishte ndërmarr veprimet konform këtyre dispozitave prapë se prapë i njëjti nuk ka çmimin që mbulon kërkesën e AK. Andaj ekspertit shqyrtues me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese dhe plotësimit të saj të merr parasysh këto të gjetura dhe të aprovoj ankesën tone si të bazuar.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverballi mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Rojet e Nderit SH.P.K" – Prishtinë

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Rojet e Nderit SH.P.K", se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 10, 59, 60, 65 dhe 72 të LPP-së dhe vendimet e OSHP-së, me arsyetimin se: "OE ankuese ka parashtruar ankesë përveç që në disa faqe të ankesës ka paraqitur-përshkruar kronologjinë rreth veprimeve të marra nga AK dhe OSHP lidhur me këtë aktivitet".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues vetëm ka bërë përshkrim kronologjik të rrjedhës së aktivitetit duke potencuar disa nga kërkesat dhe sqarimet e bëra nga AK në fazën para dorëzimit të ofertave e të cilat kërkesa kanë qenë pretendime dhe janë trajtuar me vendimet e OSHP-së nr. 735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, Vendimi e OSHP-së PSH.nr.82-83-92/20 dt. 03.03. 2020, Vendimi e OSHP-së PSH.nr.332/20 dt. 25.05.2020, si dhe Urdhëresën e OSHP-së, PSH 563/20 dt. 14.10. 2020.

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Rojet e Nderit SH.P.K" lidhur me vendimin e fundit të marr nga Menaxheri i Prokurimit i AK-së duke u thirrur në urdhëresën e OSHP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankuese është pjesërisht i bazuar sepse bazuar në nenin 59 të LPP-së, AK respektivisht ZKA dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit duhet të krijoj komision vlerësimi për vlerësim të tenderëve respektivisht në paragrafin 40.1 dhe 40.2 të RRUOPP, ku theksohet: "40.1 Duke ju referuar nenit 59, paragrafi 1, i LPP-së, për të gjitha aktivitetet e prokurimit AK, respektivisht "ZKA" në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës te prokurimit duhet të krijoj një komision të vlerësimit të tenderëve me funksione krejtësisht këshilluese për Zyrtarin përgjegjës te Prokurimit. Nga ky rregull përjashtohen aktivitetet e prokurimit me vlere minimale. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të bëjë rekomandimin për anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve për ZKA, i cili do të aprovoj të gjitha nominimet ose kur është e nevojshme do të zgjedh anëtarë alternativ për Komisionin. Anëtarët e komisionit te hapjes se tenderëve mund te shërbejnë si anëtar te komisionit te vlerësimit. 40.2 Komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast. Komisioni i vlerësimit do të vlerësoj tenderët në pajtim me kriteret e specifikuara me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si më i mirë." Në rastin konkret zyrtari përgjegjës i prokurimit i AK ka marr vendim duke u bazuar në paragrafin 40.13 të RRUOPP, ku theksohet : "40.13 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Në situata te tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund te nxjerr vendimin përfundimtar ose mund te formoj komision te ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim." Mirëpo i njëjti zyrtar respektivisht AK me rastin e publikimit të formularit "B58 Formularit mbi vendimin e autoritetit kontraktues" në platformën e E-prokurimit nuk i ka bashkangjitur letrat standarde siç parashihet me paragrafit 43.2 të RRUOPP, ku theksohet: "43.2 Formulari B58 duhet te përmbajë vendimin mbi rezultatin e



aktivitetit të prokurimit dhe Letrat Standarde përkatëse për Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme”, por me rastin e publikimit të formularit B58 të njëjtit i është bashkangjitur vetëm Vendimi i marr nga zyrtari përgjegjës i prokurimit i datës 19.10.2020.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, “se në dokumentacionin e grupit të OE të rekomanduar për kontratë respektivisht në ofertën financiare dëshmitë lidhur me vërtetimin e ATK-së të Internacional Security Association SH.P.K”, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimet lidhur me ofertën financiare respektivisht çmimeve në ofertë, të njëjtat pretendime janë trajtuar me vendimet e OSHP-së nr. 735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, Vendimi e OSHP-së, PSH 82-83-92/20 dt. 03.03. 2020, Vendimi e OSHP-së, PSH 332/20 dt. 25.05.2020 si dhe Urdhëresën e OSHP-së, PSH 563/20 dt. 14.10. 2020.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e OE ankues rreth vërtetimin të ATK-së të anëtarit të konzorciumit “Internacional Security Association SH.P.K”, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk është i bazuar sepse ky aktivitet i prokurimit është shpallur/publikuar nga AK në platformën e E-prokurimit me datën 20.05.2019, ndërsa anëtari i konzorciumit të rekomanduar për kontratë “Internacional Security Association SH.P.K” ka dorëzuar Vërtetimin e ATK-së, të nxjerr me datën 11.04.2020, në të cilin është theksuar se “është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura” andaj vërtetimi si i tillë, plotëson kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues si dhe pretendimet se “Nazeri 2000 SH.P.K” ka masë administrative të lëshuar nga institucionet e Shqipërisë si dhe për drejtuesin tjetër të kësaj kompanie Mehmet Bazaj me arsyetim se i njëjti është dënuar nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Durrës për vepër penale Shpërdorim Detyre dhe nga këto dokumente konstatohet se ky OE nuk i përmbush kriteret e përcaktuara nga AK në dokumentacionin e tenderit.”. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor nuk është parashtruar me kërkesën për rishqyrtim nga OE ankues në AK. Andaj, ky pretendim ankimor nuk është trajtuar në përputhje me paragrafin 1 të nenit 109 të LPP-së dhe nenin 9 të “Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave”. Përkundër kësaj, Paneli Shqyrtues sqaron se është obligim i autoritetit kontraktues që me rastin e rivlerësimit të ofertave duhet të marr parasysh pretendimet e OE ankues dhe të verifikoj dëshmitë e anëtarit të konzorciumit të rekomanduar për kontratë OE “Nazeri 2000 SH.P.K” nëse i njëjti është dënuar sikurse pretendon OE ankues.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “K.S.Besa Security SH.P.K.”- Prishtinë

Lidhur me pretendimin e OE ankues "K.S.Besa Security SH.P.K.", se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 56.3, 57, 59, 61 dhe 72 të LPP-së, me rastin e refuzimit të tenderin tonë me arsyetimin: "OE ankuese ka parashtruar ankesë, ka paraqitur pretendim lidhur me vendimin e fundit të marr nga Menaxheri i Prokurimit i AK-së duke u thirrur në urdhëresën e OSHP-së pa bërë vlerësim dhe krahasim të ofertave".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar sepse bazuar në nenin 59 të LPP-së, AK respektivisht ZKA dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit duhet të krijoj komision vlerësimi për vlerësim të tenderëve respektivisht në paragrafin 40.1 dhe 40.2 të RRUOPP, ku theksohet: "40.1 Duke ju referuar nenit 59, paragrafi 1, i LPP-së, për të gjitha aktivitetet e prokurimit AK, respektivisht "ZKA" në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit duhet të krijoj një komision të vlerësimit të tenderëve me funksione krejtësisht këshilluese për Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit. Nga ky rregull përjashtohen aktivitetet e prokurimit me vlere minimale. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të bëjë rekomandimin për anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve për ZKA, i cili do të aprovoj të gjitha nominimet ose kur është e nevojshme do të zgjedh anëtarë alternativ për Komisionin. Anëtarët e komisionit të hapjes së tenderëve mund të shërbejnë si anëtar të komisionit të vlerësimit. 40.2 Komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast. Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë tenderët në pajtim me kriteret e specifikuar me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si më i mirë." Në rastin konkret zyrtari përgjegjës i prokurimit i AK ka marr vendim duke u bazuar në paragrafin 40.13 të RRUOPP, ku theksohet: "40.13 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Në situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim." Mirëpo i njëjti zyrtar respektivisht AK me rastin e publikimit të formularit "B58 Formularit mbi vendimin e autoritetit kontraktues" në platformën e E-prokurimit nuk i ka bashkangjitur letrat standarde siç parashihet me paragrafin 43.2 të RRUOPP, ku theksohet: "43.2 Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe Letrat Standarde përkatëse për Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme", por me rastin e publikimit të formularit B58 të njëjtit i është bashkangjitur vetëm Vendimi i marr nga zyrtari përgjegjës i prokurimit i datës 19.10.2020.

Lidhur me pretendimet e OE ankues, se "ndaj dokumentacionit të grupit të OE të rekomanduar për kontratë respektivisht në ofertën financiare respektivisht mos plotësimin të kushtit prej 250 € *pagë* për punëtor dhe pretendimin rreth çmimeve jo normalisht të ulëta". Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimet lidhur me ofertën financiare respektivisht çmimeve në ofertë, të njëjtat pretendime janë trajtuar me Vendimin e OSHP-së PSH.nr.735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, Vendimin e OSHP-së PSH.nr.82-83-



92/20 dt. 03.03.2020, Vendimin e OSHP-së PSH.nr.332/20 dt. 25.05.2020, si dhe Urdhëresën e OSHP-së PSH.nr.563/20 dt. 14.10.2020.

Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, shkresat e lëndës dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që ti shqyrtoj të gjitha vërejtjet e dhëna në vendimet paraprahe, si dhe të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së,

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK "KK-Prishtinë";
- 1x1 OE "Rojet e Nderit"- SH.P.K.-Prishtinë;
- 1x1 OE K.S."Besa Security"SH.P.K-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.